


Investimet kapitale



RAPORTI 2016

Prishtina
po bëhet



Investimet kapitale

Kur e filluam qeverisjen në Komunën e Prishtinës, Komunën e gjetëm me buxhet të miratuar, pa plan dhe projekte për realizimin e atij buxheti. Fshatrat ishin me mungesë të jashtëzakonshme të investimeve në infrastrukturë rrugore, qyteti ishte me probleme shumë të mëdha infrastrukture dhe me shumë projekte të filluara dhe të bllokuara. Ne menjëherë filluam që të projektojmë rrugë, kanalizime, trotuare e projekte të tjera. Filluam komunikimin e drejtëpërdrejtë me qytetarë dhe shumë shpejt, si rezultat i këtij bashkëpunimi, i implementuam projektet të cilat ishin bllokuar. Tani kemi arritur që të funksionalizojmë bashkëpunimin e qytetarëve me Komunën, ku ata janë bërë pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes në investimet e Komunës së Prishtinës.

Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, gjatë këtyre tri viteve, ka pasur për synim investimet në lagjet dhe fshatrat e Prishtinës, ku kërkesat e banorëve kanë qenë më të mëdha dhe të nevojshme.



Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave gjatë kësaj periudhe, ka kryer këto aktivitete: hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave, shqyrtimi i kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e Komunës, njoftimi në kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante, me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimi i paramasave dhe paralogarive, si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve konform kontratave dhe projekteve etj.

Vetëm gjatë vitit 2016, drejtoria ka proceduar 1402 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve, për: ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike-leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrolimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj. Nga numri i përgjithshëm, prej 1402 kërkesave të pranuara, 1401 janë zgjidhur, kurse vetëm një lëndë është bartur për vitin 2017.



Drejtoria e Investimeve Kapitale gjatë këtij viti ka realizuar **103** kontrata dhe ka realizuar **98.55 %** të buxhetit.

Shuma e mjeteve të realizuara nga projektet e bartura në vitin 2016 është **3.012.752.81 €**

Gjithsej shuma e mjeteve të realizuara nga buxheti për vitin 2016 është **7.403.319,47 €**

Trotuaret

Ujësjellës

Bulevardet

Hortikultura

Rrugë

Kanalizime

Kolektori

Rrugët me kubëza

Investimet në shkolla

Stadiumet

Qendra të mjekësisë familjare

Drejtoria e Investimeve Kapitale gjatë vitit 2016 ka realizuar:

20.32km asfalt (kubëza) në rrugë urbane

63.80km asfalt (kubëza) në rrugë rurale

84.10km gjatësia e rrugëve urbane dhe rurale

163,462.68m² rrugë me kubëza

37,096.99m² trotuare

35,363.50m' kanalizim fekal

17,002.00m' kanalizim atmosferik

5,499.53m' ndriçimi publik

6,980.00m' ujësjellës



Rrugët

Përgjatë kësaj periudhe të qeverisjes, Drejtoria e Investimeve Kapitale ka pasur për synim investime në ndërtimin e rrugëve si në qytet, po ashtu dhe në fshatra, ku ndarja e investimeve është bërë në mënyrë të barabartë për të gjithë banorët e Prishtinës. Duke pasur parasysh nevojën e qytetarëve për ndërhyrje të shpejtë dhe serioze në rregullim e infrastrukturës rruore, kemi ndërtuar këto rrugë:

- Ndërtimi i rrugës "Naser Hajrizi"
- Ndërtimi i rrugës "Stambolli" - faza e dytë
- Ndërtimi i rrugës Dabishevc-Mutivodë
- Ndërtimi i rrugës Llukar-Siqevë
- Ndërtimi i rrugës Breznicë-Barilevë
- Ndërtimi i rrugës në Koliq-Lagjja Peraj
- Ndërtimi i rrugës "Hasan Remniku" -Kolovicë
- Ndërtimi i rrugëve në Hajkobillë
- Ndërtimi i rrugës Rimanisht-Vranidoll
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Mirko Gashi" dhe "Gazë Përgjeni"
- Ndërtimi i rrugës Keqekollë-Nishec
- Ndërtimi i rrugës "Mithat Frashëri"
- Ndërtimi i rrugës Matiqan-Butovc-Kolovicë
- Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Shashkovc-Prishtinë
- Ndërtimi i rrugës pranë sistemit "Ibër-Lepenc"-Bërnicë e Poshtme
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq, lagjja Sheqiraj dhe ndërtimi i rrugës në fshatin Grashticë, lagjja Kopranët.



- Ndërtimi i rrugës Slivovë-Kukaj
- Ndërtimi i rrugës lidhëse me rrugën "Isa Kastrati" në lagjen "Rikonstruktimi i rrugës "Luan Haradinaj"
- Ndërtimi i rrugës në Hajvali dhe ndërtimi i trotuareve në rrugën "Muharrem Fejza"
- Rikonstruktimi i rrugës "Garibaldi" dhe "Perandori Justinian"
- Ndërtimi i rrugës Lebanë-Prugovc
- Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni-Lagjja Vakovc
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Bardhosh
- Ndërtimi i rrugës Barilevë-Besi
- Ndërtimi i rrugës Dabishevc-Mutivodë
- Ndërtimi i disa rrugëve në lagjen "Kolovicë"
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën Çagllavicë - "Ibër Lepenc".



- Ndërtimi i rrugës "Perandori Justianian" përballë Katedrales
- Ndërtimi i rrugës në Koliq-lagjja Peraj
- Rindërtimi i disa krahëve të rrugëve "Shaban Shala", "Xhevat Begolli", "Ibrahim Kelmendi", "Uilliam Shekspir", "Gjon Serreqi", "Asllan Pireva" dhe "Rexhep Kabashi"
- Ndërtimi i disa rrugëve lidhëse me rrugën për Gazimestan
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Hysen Terpeza" dhe krahët e saj në lagjen "Veternik"
- Furnizimi dhe montimi i materialit për ndërtimin e kanalit kabllor dhe zhvendosja e kabllove 0.4V dhe 10kV në rrugën "Naser Hajrizi"

- Zbatimi i projektit të nyjes në fund të rrugës "Avdyl Rama", disloktimi i trafos, shtyllave elektrike dhe trajtimi i zonës
- Ndërtimi i rrugeve në Llukar dhe Makovc
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Trepça"
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Sali Matoshi" në Prishtinë dhe ndërtimi i rrugeve lokale në fshatin Grashticë
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Dabishevc-lagjja Dulaj
- Ndërtimi i rrugeve në lagjen "Veternik" dhe në lagjen "Mat"
- Ndërtimi i rrugës në lagjen e Dulevitëve-Suteskë
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Barilevë- Lagjja Kurti
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Hajvali, në lagjen e Vitialive
- Ndërtimi i rrugeve në fshatin Koliq, Lagjja Qokaj
- Ndërtimi i rrugeve në fshatin Koliq, lagjja Bicaj dhe Vol
- Furnizimi dhe montimi i materialit për ndërtimin e kanalit kabllor dhe zhvendosja e kabllove 0.4V dhe 10kV në rrugën "Naser Hajrizi"
- Hartimi i projekteve të infrastrukturës rruore në Prishtinë





Në komunën e Prishtinës
nuk ka mbetur asnje fshat
ku nuk është investuar
në infrastrukturën rrugore



Sanimet

Për qasje sa më të mirë të banorëve në rrugët e kryeqytit dhe lehtësira në përditshmërinë e tyre kemi bërë sanime në disa rrugë dhe trotuare:

Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugët dhe trotuaret e qytetit për vitin 2015

Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugët dhe trotuaret në komunën e Prishtinës për vitin 2016

Reabilitimi, planifikimi dhe stabilizimi i dheut nga rrëshqitja në fshatin Siqevë



Kanalizimet

Një ndër prioritetet e Drejtorisë së Infrastrukturës ka qenë edhe ndërtimi i kanalizimeve, aty ku ka pasur mungesë të tyre.

Në vazhdën e këtij prioriteti kemi ndërtuar dhe intervenuar në lagjet dhe fshatrat e Prishtinës, ku gjithsej janë realizuar 35,363.50m' kanalizim fekal dhe 17,002.00m' kanalizim atmosferik.

Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Llukar



Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Kolovicë

Ndërtimi i kanalizimit fekal në Bardhosh,
disa lagje në Barilevë dhe lagjen e V-të
në Prugovc

Rindërtimi, sanimi dhe zgjerimi i
disa rrugëve dytësore, si dhe rindërtimi, sanimi
i kanalizimeve fekale parësore dhe dytësore

Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kanalizimi
fekal në rrugën mbi lumin Prishtina

Ndërtimi i rrugëve lokale dhe kanalizimeve
fekale në lagjen “Arbëria”

Ndërtimi i infrastrukturës në Sofali dhe kanal-
izimi fekal në Besi

Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kanalizimi
fekal në rrugën mbi lumin Prishtina



Kubëzat



163,462.68m² rrugë me kubëza janë shtruar gjatë vitit 2016 në lagjet dhe fshatrat e ndryshme të komunës së Prishtinës. 33 rrugë të ndryshme janë shtruar me kubëza vetëm në lagjet, "Veternik" dhe "Mat", pastaj edhe në Lagjen e Spitalit, "Kodra e Trimave", "Kolovicë", "Breshka".

Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza betoni në lagjen "Mati"

Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza betoni në lagjen "Hajvalia"

Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza betoni në Lagjen e Spitalit në Prishtinë



Ndërtimi i disa rrugëve me kubëza betoni

Ujësjellësi

6,980.00m' ka qenë vlera që është investuar në rrjetin e ujësjellësit për këtë vit.

Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Slivovë

Zhvendosja e rrjetit kryesor furnizues të Batllavës

Muret

Për shkak të dëmtimeve të mëdha, si pasojë e vërvshimeve, kemi intervenuar, duke ndërtuar mure mbrojtëse në fshatin Mramor, rruga "Hasan Mremniku", lagjja "Velania" etj.

Ndërtimi i mureve mbrojtëse

Ndërtimi i murit betonarme në lagjen "Velania"

Përmirësimi i gjendjes së murit Alpin në Gërmi

Stadiumet

Renovimi i Stadiumit të qytetit të Prishtinës
Ndërtimi i stadiumit të futbollit në Hajvali



Bulevardet

Ndërtimi i bulevardit në rrugën "Garibaldi"

Ndërtimi i bulevardit në rrugën "Luan Haradinaj"

Ndërtimi i bulevardit në rrugën "Perandori Justinian"

Ndërtimi i bulevardit mbi "Kurrijz"





Urat

Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të Unazës qëndrore

Ndërtimi i urave betonarme në fshatrat e komunës së Prishtinës



Punishtja me rastin e fillimit të betonimit të shtyl-lave në kuadër të ndërtimit të urave që e lidhin rre-thrrotullimin në lagjet "Lakërishta" dhe "Arbëria".

Urat që e lidhin rrethqarkullim në lagjet “Lakërishta” dhe “Arbëria”

Ky projekt dyvjeçar është një prej projekteve kapitale të rëndësishme për Komunën e Prishtinës, pjesë e unazës qendrore dhe investimi i Komunës së Prishtinës është afër 2 milionë euro.

Njëra prej urave ka gjatësi prej 194 metra dhe lidh rrethrotullimin me rrugën mbi hekurudhë, ndërsa ura tjetër me gjatësi 77 metra, lidh rrethrrrotullimin me rrugën nën hekurudhë.



Shkollat

- Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të disa shkollave
- Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive
- Rregullimi i oborrit të shkollës fillore "Ismail Qemajli"
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike të shkollës "Shtjefën Gjeqovi"
- Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e nyjave sanitare –kontratë kornizë 3-vjeçare
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën fillore "Shkëndija" në Hajvali – aneksi
- Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore "Faik Konica"
- Rikonstruktimi dhe gëlqerosja e shkollave të Prishtinës
- Instalimi i ngrohjes qëndrore në shkollat e fshatrave
- Ekzekutimi i punimeve me pleksigllas në disa shkolla dhe punime tjera
- Rikonstruktimi i çerdhes në lagjen "Sofalia"
- Ndërtimi i objektit parashkollar në lagjen "Kodra e Trimave".



Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore "Faik Konica"

Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollat e fshatrave ka përfunduar në trembëdhjetë (13) shkolla të fshatrave:

SHFMU "Avni Rrustemi"- Halitaj, SHFMU "Nëna Tereza"- Vranidoll, SHFMU "Filip Shiroka"- Slivovë, SHFMU "Dëshmorët e 1921"- Prapashticë, SHFMU "Dëshmorët e 1921"- Balaj, SHFMU "Dëshmorët e 1921"- Balaj, SHFMU "Azemi e Salihu"- Dabishevcë, SHFMU "Azemi e Salihu"- Hajkobilë, SHFMU "Azemi e Salihu"- Gllogovicë, SHFMU "Tefik Çanga" – Ballaban, SHFMU "Tefik Qanga"- Koliq 1, SHFMU "Tefik Qanga" - Koliq2, SHFMU "Teuta" – Grashticë, dhe SHFMU "Isa Boletini"- Busi.



Mirëmbajtja e ngrohjes qëndrore



IP "Dielli", IP "Ngjyrat", IP "Botanika", IP "Buzëqeshja", IP "Gëzimi Ynë", IP "Shtëpia Magjike", SHFMU "Meto Bajraktari", SHFMU "Dardania", SHFMU "Nazim Gafurri", SHFMU "Ganimete Tërbeshi", SHFMU "Gjergj Fishta", SHFMU "Hilmi Rakovica", SHFMU "Dituria", SHFMU "Ali Kelmendi", SHFMU "Model" SHFMU "Shkolla e Gjelbërt", SHML "Equerem Qabej", SHFMU "Model", SHFMU "Shkolla e Gjelbërt", SHML "Gjin Gazulli", SHML "Ahmet Gashi", SHML "7 Shtatori", SHML "28 Nëntori", SHFMU "Emin Duraku", SHFMU "Shkëndija", SHFMU "Avni Rrustemi", SHFMU "Xhemail Mustafa", SHFMU "Iliria", SHFMU "Asim Vokshi", SHFMU "Pavarësia", SHFMU "Mitrush Kuteli", SHML "Ali Sokoli", SHML "Hoxhë Kadri Prishtina", SHML "Shtjefën Gjeçovi", SHML "Xhevdet Doda", dhe SHFMU "7 Marsi".

Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e nyjave sanitare




SHFMU "Xhemail Mustafa", SHML "Sami Frashëri 2", SHFMU "Gjergj Fishta", SHFMU "Nazim Gafurri" IP "Ngjyrat", SHFMU "Ganimete Tërbeshi", SHFMU "Ismail Qemajli", SHML "Abdyl Frashëri", SHML "7 Shtator", SHFMU "Pjetër Bogdani", SHFMU "Zenel Hajdini", SHML "Prenk Jakova", IP "Gëzimi Ynë" IP "Dielli", IP "Zogjtë", SHFMU "Pavarësia", IP "Yllkat", SHFMU "Meto Bajraktari", SHFMU "Xhavit Ahmeti", SHFMU "Avni Rrustemi"-Halitaj, SHFMU "Nëna Tereza" -Vranidoll, SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Prapashticë, SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Balaj, SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Balaj, SHFMU "Azemi e Salihu"-Dabishevcë



SHFMU "Azemi e Salihu"-Hajkobillë, SHFMU "Azemi e Salihu"- Gllogovicë

SHFMU "Tefik Çanga" – Ballaban, SHFMU "Tefik Qanga"- Koliq 1, SHFMU "Tefik Qanga" – Koliq 2, SHFMU "Teuta" – Grashticë, dhe SHFMU "Isa Boletini"- Busi

Rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e kulmeve të shkollave



**Me kontratë kornizë për tri (3) vijet, me vlerë 77,818.00€
për vitin 2016, është renovuar në këto
institucione arsimore:**

SHFMU "Avni Rrustemi", SHML "Abdyl Frashëri", IP "Dielli", SHFMU "Asim Vokshi", IP "Lulevera"
SHFMU "Naim Frashëri", IP "Buzëqeshja", SHFMU "Isa Boletini", SHFMU "Teuta", SHML "Abdyl Frashëri"
SHFMU "Asim Vokshi", SHFMU "Naim Frashëri", SHFMU "Shkëndija", SHFMU "Filip Shiroka", SHFMU "Azemi e Salihu"- Hajkobillë, SHFMU "Azemi e Salihu"- Gllogovicë, SHFMU "Azemi e Salihu"- Dabishevcë, SHFMU "Nëna Tereza -Vranidoll, SHFMU "Tefik Qanga"-Koliq 1, SHFMU "Tefik Qanga"-Koliq 2, SHFMU "Tefik Çanga"-Ballaban, SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Prapashticë, SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Ballaj, IP "Lulevera", IP "Buzëqeshja", SHFMU "Ditët e Minatorit"-Kishnicë, dhe SHFMU "Ditët e Minatorit"-Shashkoc.

Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive

SHFMU "Xhemail Mustafa", SHFMU "Dëshmoret 1921", SHFMU "Mitrush Kuteli", SHFMU "Naim Frashëri", SHFMU "Gjergj Fishta", SHFMU "Shkëndija", SHFMU "Dituria", SHFMU "Isa Boletini"- Busi, SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Balaj, SHFMU "Teuta" –Grashticë, SHFMU "Ismail Qemajli", SHFMU "Azemi e Salihu"- Hajkobillë, SHFMU "Azemi e Salihu"- Gllogovicë, SHFMU "Nëna Tereza –Vranidoll, dhe SHFMU "Dëshmorët e 1921"-Prapashticë.





Terreni i ri sportiv në fshatin Prapashticë




Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive

Hortikultura

- Furnzimi dhe montimi i dyerëve të rrrethojës së Qendrës rekreative në Gërmë
 - Furnzimi i shtëpizave me invertar (perde, perde gome, tavolina, frigorifer, qilima etj)
 - Rikonstruksioni i objektit të kuzhinës qëndrore
-

Rikonstruktimi dhe gëlqerosja e shkollave

IP "Xixëllonjat", SHFMU "Elena Gjika", SHFMU "Gjergj Fishta", SHFMU "Ismail Qemalili", SHFMU "7 Marsi", SHFMU "Hilmi Rakovica", SHFMU "Avni Rrustemi", SHFMU "Dituria", SHFMU "Fan S. Noli", SHFMU "Isa Boletini", SHFMU "Nexhmi Mustafa", SHFMU "Rilindja", SHFMU "Pavarësia", SHFMU "Sami Frashëri", SHML "Ahmet Gashi", SHFMU "Dardania", IP "Gëzimi Ynë", SHFMU "Avni Rrustemi"-Suteskë, dhe SHFMU "Zenel Hajdini".





Këndi i lojërave në lagjen "Kalabria"

Projekte të tjera të rëndësisë së veçantë

- Renovimi i garazhit të NK "Trafikut Urban"
- Riparimi dhe renovimi i objekteve të Brigadës profesionale të zjarrëfikjes
- Implementimi i projektit "Bllok pas Blloku" në lagjen Bregu i Diellit
 - Furnizimi dhe montimi i inventarit dhe materialeve të tjera përfunksionalizimin e qendrës për "Business Process Outsourcing"
 - (Qendra e Biznesit për Proces Transferime)
 - Furnizimi dhe vendosja e ashensorit të jashtëm në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, si dhe punët përcjellëse
 - Renovimi i Dispanserit të Mushkërive dhe ambulancave shëndetësore në fshatrat e Prishtinës –LOT 2
 - Renovimi i Dispanserit të Mushkërive në Prishtinë –LOT 1
 - Ndërtimi i këndeve të lodrave përfëmijë –pjesa I
 - Ndërtimi i këndeve të lodrave përfëmijë –pjesa II
 - Konkurs projekti: Këndi i librave në Prishtinë
 - Konkurs projekti: Tregu i Luleve në Prishtinë
 - Hartimi i projekteve të vogla dhe të mesme për objekte të reja rikonstruktim, adaptim dhe mirëmbajtje

Projektet e realizuara gjatë periudhës 2014-2015

PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS LOKALE DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE SHUMËVJEÇARE

Duke filluar nga viti 2014, të gjitha investimet që janë bërë deri më tanjë janë bërë sipas projekteve, ndryshe prej viteve të tjera, ku shumica e investimeve janë bërë në mungesë të projekteve. Gjatë dy viteve (2014-2015), kemi përfunduar **projektimin e afër 100 rrugëve** dhe **projektimin e 20 kanalizimeve** në fshatra e lagje të komunës. Kemi projektuar edhe **mure mbrojtëse** dhe **ura** në fshatra.


- Zhbllokimi dhe përfundimi i punëve te rrethrotullimi në Vetenik;
- Zhbllokimi dhe përfundimi i punëve te rrethi i Arbërisë;
- Largimi i kundërmimit nga sheshi "Nëna Terezë";
- Trajtimi fizik dhe estetik i disa prej rrugëve të kryeqytetit, si: rrugët: "Rexhep Luci", "Garibaldi", "Qamil Hoxha", "Dëshmorët e Kombit";
- Trajtimi i trotuarit dhe mbjelljes se fidanëve në rrugët: "Imzot Nikë Prelaj", "Perandori Justinian", "Sylejman Vokshi", "Tringë Smajli", "Eqrem Çabej" dhe "Fehmi Agani";
- Rindërtimi i 12 rrugëve me asfalt dhe kubëza në lagjen "Mati";
- Ndërtimi i rrugës "Stambolli" (faza e parë);
- Ndërtimi i rrugës "Stambolli" (faza e parë);

- Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku" (faza e dytë);
- Ndërtimi i rrugës Siqevë-Sharban;
- Ndërtimi i rrugës Bërnicë e Epërme – Sharban;
- Sanimi i 10 rrugëve me zhavorr;
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Jusuf Gërvalla" - me 5 krahët e saj;
- Asfaltimi i rrugës në Hajvali;
- Ndërtimi i 7 rrugëve në lagjen "Kalabria";
- Vazhdimi i rrugës paralele me rrugën Prishtinë – Shkup;
- Ndërtimi i rrugës Slivovë – Dragovc;
- Ndërtimi i rrugës "Malush Kosova" – faza III;
- Ndërtimi i rrugës "Mbretëresha Teutë" dhe krahët e saj në anën e djathtë;
- Ndërtimi i 21 rrugëve me kubëza betoni në lagjen "Mati 1";
- Asfaltimi i rrugës dhe ndërtimi i murit mbrojtës në lagjen "Bërbatovc" në Barilevë;
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Besi dhe trotuari në fshatin Miloshevë;
- Ndërtimi i rrugës Prishtinë - Sinidoll - Bërnicë e Epërme - Bardhosh (faza e parë);
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Shaqir Igrishta" dhe 23 rrugë lidhëse;
- Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku"(krahu i dytë, djathtas);
- Ndërtimi i rrugës nga rruga magjistrale Prishtinë - Gjilan (krahu i djathtë, te pompa e benzinës "Mili Petrol 2 ") në Hajvali;
- Ndërtimi i rrethrrrotullimit në dalje të Prishtinës-drejtimi i Vetenikut (pjesa e parë);
- Ndërtimi i rrugës "Naser Hajrizi";

- Ndërtimi i rrethrrrotullimit në dalje të Prishtinës (drejtimi i Vetenikut, pjesa e tretë);
- Rregullimi i rrugës dhe kanalit të jashtëm të shkollës së mesme "28 Nëntori";
- Rindërtimi i rrugëve "Remzi Demolli", "Mihajlo Pupin", "Zijaver Vllasaliu" dhe krahët e rrugës;
- Ndërtimi i rrugës "Stanbolli" (faza e dytë);
- Ndërtimi i rrugës te parku në lagjen "Arbëria";
- Mbulimi i Xhamisë së Çarshisë;
- Ndërtimi i kanalizimit fekale në rrugën "Mbretëresha Teutë";
- Ndërtimi i rrugës "Basri Canolli";
- Ndërtimi i rrugës "Gallapi";
- Ndërtimi i rrugës "Esat Mekuli";
- Ndërtimi i rrugës "Xheladin Kurbaliu";
- Ndërtimi i rrugës prej rrugës së Mramorit deri te Pylli i Ar-iut-Badovc;
- Ndërtimi i infrastrukturës në 10 rrugë të lagjes "Kalabria";
- Ndërtimi i rrugës Llukar-Siqevë;
- Sanimi i gropave dhe deformimeve të shtresave të asfaltit në rrugët dhe trotuaret e qytetit;
- Ndërtimi i rrugës paralele me rrugën "B";
- Ndërtimi i rrugës Breznicë – Barilevë;
- Ndërtimi i rrugës "Hasan Remniku" – Kolovicë;
- Ndërtimi i rrugës Bërnicë e Poshtme - M2;
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Dabishevc, lagjja Hasimi dhe Babiq;
- Ndërtimi i rrugës në Koliq-lagjja Peraj;
- Ndërtimi i rrugëve në Hajkobillë – 9 rrugë;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Lagjen e Ramabajve – Hajvali;

- Ndërtimi i rrugës në Rimanisht – Vranidoll;
- Ndërtimi i rrugës Koliq - Keqekollë";
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Mirko Gashi" dhe "Gazë Përgjeni";
- Ndërtimi i rrugës Keqekollë – Nishec;
- Ndërtimi i rrugës "Mithat Frashëri";
- Ndërtimi i rrugës lokale në Lagjen Sylaj Busi, fshati Mramor;
- Ndërtimi i murit mbrojtës në Rimanishtë, me gjatësi L=110m;
- Ndërtimi i rrugës Matiqan-Butovc-Kolovicë;
- Ndërtimi i rrugës Sharban-Koliq;
- Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Shashkovc – 10 rrugë me asfalt;
- Ndërtimi i rrugës pranë sistemit "Ibër Lepenc"-Bërnicë e Poshtme;
- Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni-Lagja Vakovc (Marevc);
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq- Lagjja Bushovit;
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Koliq, Lagjja Sheqiraj dhe ndërtimi i rrugës në fshatin Grashticë, Lagjja Kopranët;
- Ndërtimi i rrugës lidhëse me rrugën "Isa Kastrati" në lagjen "Mati 1", rruga K3-2;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Veternik – 8 rrugë;
- Rikonstruksioni i rrugës rr."Luan Haradinaj";
- Ndërtimi i rrugës "Mithat Frashëri";
- Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën "Butrinti"-Lagjja Gjinaj;
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Llukar-Lagja Obzovik; Ndërtimi i parkingjeve dhe trotuareve në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit";
- Ndërtimi i rrugës në Hajvali dhe ndërtimi i trotuareve në rrugën "Muharrem Fejza";

- Rikonstruktimi i rrugëve "Garibaldi" dhe "Perandori Justinjan";
- Ndërtimi i rrugëve në fshatin Prugovc – 15 rrugë;
- Ndërtimi i rrugës te Pallati i Drejtësisë;
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Lebanë-Prugovc;
- Ndërtimi i rrugëve lokale dhe kanalizimeve fekale në lagjen "Arbëria" – 14 rrugë;
- Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në lagjen "Arbëria", rr. "Qemal Stafa" – 21 rrugica;
- Ndërtimi i rrugës në Grashticë, lagja Cervadik;
- Ndërtimi i rrugës "Enver Maloku" - faza e parë;
- Asfaltimi i rrugës në Hajvali;
- Ndërtimi i rrugës Besi - Prugovc – Barilevë, e tërë infrastruktura";
- Ndërtimi i rrugëve lokale në lagjen "Përroi i Njelmët" – 22 rrugë;
- Ndërtimi i kanalizimeve fekale në lagjen "Përroi i Njelmët" – 4 kanalizime;
- Ndërtimi i rrugëve me kubëza të betonit në Hajvali – 12 rrugë;
- Ndërtimi i rrugëve me kubëza të betonit në Lagjen e Spitalit – 43 rrugë;
- Ndërtimi i kanalizimeve në fshatin Vranidoll, Prugovc;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Llumnicë, Barilevë; Sanimi dhe rikonstruktimi i rrugëve në disa lagje dhe fshatra të Prishtinës (janë rregulluar 14 rrugë dhe 30 kanalizime);



Ndërtimi, rregullimi dhe sanimi i kanalizimeve dhe rregullimi i shtratit të lumbit:

- Rregullimi i shtratit të lumbit Prishtina, faza I segmenti Fusha e Pajtimit;
- Rregullimi i përroit dhe kanalizimit fekale prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjeve "Arbëria" dhe "Kodra e trimave";
- Sanimi i kanalizimit fekal te sheshi "Nëna Terezë";
- Ndërtimi i kanalizmit fekal Bardhosh - Prugovc – Barilevë;
- Kolektori betonarme për largimin e ujit atmosferik dhe kanalizmit fekal në lagjet "Mat" dhe "Kalabria";
- Ndërtimi i kanalizmit fekal në Besi – Bardhosh;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal nga fshati Shkabaj në drejtim të lagjeve "Arbëria" dhe "Kodra e Trimave";
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në Lagjen e Xhafollëve të fshatit Barilevë;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në Mramor - Suteskë dhe vazhdimi i kanalizmit fekal në rrugën "Ibrahim Fehmiu";
- Ndërtimi i kanalizmit fekal dhe trotuarëve në fshatin Vranidoll;
- Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Sinidoll dhe Bërnicë;
- Rrjeti i ujësjellësit për fshatrat Breznicë – Kozaricë;
- Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat Sinidoll dhe Bërnicë;
- Ndërtimi i kanalizmit fekal dhe trotuarëve në fshatrat Vranidoll, Serovc dhe Lebanë ;
- Rindërtimi, sanimi i kanalizimeve fekale parësore dhe dytësore, si dhe ndërtimi, sanimi dhe zgjerimi i disa rrugëve dytësore në territorin e komunës se Prishtinës;
- Ndërtimi i urave betonarme në fshatrat e komunës së Prishtinës – 16 ura;

Rregullimi i hapësirave publike:

- Rregullimi i parkingut dhe hapësirave gjelbëruese në Ulpijanë;
- Ndërtimi i dy vendparkimeve në lagjen ‘Lakërishta’, prapa bankës ProCredit;
- Rregullimi i platosë pranë çerdhes së fëmijëve “Lulevera” në lagjen “Dardania” në Prishtinë;
- Rregullimi i platosë pranë PTK-së në lagjen “Dardania”;
- Rregullimi i parkut në lagjen “Dardania” në Prishtinë;
- Ndërtimi i Bulevardit mbi Kurrit;

Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe terreneve sportive në lagje të ndryshme të qytetit:

- Rr. “Afrim Logja”, Bregu i Diellit (në proces)
- Rr. “28 Nëntori” Dardani
- Rr. “Shefqet Shkupi” Kalabri
- Rr. “Vëllezërit Fazliu” Kodra e Trimave (në proces)







Prishtina
po bëhet